



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-244-183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Tel: +381-38-245-801 (Centrali); +381-243-747 (Dekani); +381-38-243-748 (Sekretari)

Ref. nr.

Prishtinë,

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Fakultetit të Edukimit Fizik dhe i Sportit – Universiteti i Prishtinës

dhe

Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Faik Konica”

Neni 1 – Palët nënshkruese

Ky memorandum bashkëpunimi lidhet ndërmjet Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit – Universiteti i Prishtinës (në vijim: Fakulteti), dhe ShFMU “Faik Konica” (në vijim: Shkolla).

Neni 2 – Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandum është rregullimi i bashkëpunimit për zhvillimin e praktikës mësimore në lëndën Didaktikë e Edukimit Fizik, me qëllim që studentët e Fakultetit të fitojnë përvojë praktike dhe aftësi pedagogjike, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin cilësor të orëve të Edukimit Fizik në Shkollë.

Neni 3 – Fusha e bashkëpunimit

1. Studentët e Fakultetit do të realizojnë praktikën mësimore ditë e hënë pranë Shkollës sipas orarit të përcaktuar:

Ora	Koha	Klasa
1	08:30 – 09:15	
2	09:20 – 10:05	
3	10:15 – 11:00	II/4
4	11:05 – 11:50	II/2 ose III/4
5	11:50 – 12:50	Dreka
6	12:50 – 13:35	II/5 ose V/5
7	13:45 – 14:30	I/3 ose V/5
8	14:35 – 15:20	IV/2 ose V/3

- Praktika do të mbahet çdo të hënë, në periudhën e paraparë me marrëveshje mes palëve.
- Fakulteti obligohet të sigurojë mbikëqyrjen akademike dhe pedagogjike të studentëve ndersa Shkolla obligohet të sigurojë hapësirat dhe kushtet e nevojshme për realizimin e praktikës, në përputhje me programin mësimor.

Neni 4 – Sjellja dhe përgjegjësia e studentëve

- Studentët janë të obliguar të sillen me korrektësi, respekt dhe kujdes të veçantë ndaj nxënësve gjatë zhvillimit të praktikës.
- Studentët duhet të tregojnë nivel të lartë profesionalizmi dhe të jenë model pozitiv për fëmijët.
- Përgjegjës për mbikëqyrjen dhe sjelljen e studentëve gjatë praktikës është profesori i lëndës përkatëse, **Prof. Asst. Dr. Besnik Morina**


Neni 5 – Afati i bashkëpunimit

Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet i vlefshëm deri në përfundimin e praktikës, (viti akademik 2026-26) me mundësi vazhdimi pasatj sipas marrëveshjes së përbashkët.

Neni 6 – Dispozita të përgjithshme

- Çdo çështje që nuk është paraparë në këtë memorandum, do të rregullohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet palëve.
- Palët zotohen të zhvillojnë bashkëpunim të ndërsjellë, të bazuar në mirëkuptim dhe respect.

Për Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit/UP
 Prof. Asst. Dr. Malsor Gjonbalaj
 Prodekan për çështje mësimore



Për ShFMU “Faik Konica”
 Kosovare Makolli-Leci
 Zv.Drejtori/Drejtoresha

